

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 23 QERSHOR 2022

Zonja Kryetare, ju sapo njoftuat se në rendin e ditës të seancës së sotme është përfshirë edhe akti normativ për kompensimin e çmimeve që lidhen me disa tenderë publikë të zhvilluar. Unë besoj se është e pamundur që kjo pikë të shqyrtohet sot, sepse, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, një akt i tillë nuk mund të vijë në seancë pa mbaruar shqyrtimi i tij në të gjitha komisionet përkatëse. Është fakt i dokumentuar që në mbledhjen e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, si komision për dhënie mendimi, ky projektligj nuk u shqyrtua dot, jo për mungesë dëshire të komisionit, as për ndonjë shkak tjetër, por sepse vetë përfaqësuesit e qeverisë, të cilët duhet të mbronin ligjin, e patën të pamundur të vijnë për shkak të impenjimeve të tyre në komisione të tjera.

Nëse do të vazhdoni, kjo do të ishte një shkelje e padëgjuar e Rregullores, sepse pa mbaruar punë komisionet, sikurse është e detyrueshme, jo fakultative, një akt i tillë nuk mund të vijë në seancë. Kjo punë mund të përfundojë fare mirë, se asgjë e jashtëzakonshme nuk do të ndodhë, por zbatimi i Rregullores në këtë rast është minimal. Praktikisht, ky akt duhet të shtyhet që të mbarojë shqyrtimin përkatës, se një komision nuk mund të privohet nga e drejta për të dhënë mendim e tij vetëm se përfaqësuesve të qeverisë nuk u del koha apo kanë përplasje me impenjimet e tyre. Në të kundërt, do të ishte shumë e rëndë të vazhdonim sot me shqyrtimin e tij këtu.